

**STATUTI**  
**I SHOQËRISË MË PËRGJEGËSI TË KUFIZUAR**  
**“GRAMOZI GREEN ENERGY” SHPK**

Sot, më 27.06.2023 (njëzet e shtatë qershor dymijë e njëzetë e tre) unië, i nënshkruari/ Ortak themelues:

- (i) **Adriatik Nazmi Sheko**, shtetas shqiptar dhe amerikan, lindur më 07.09.1970 lindur në Ersekë, Kolonjë dhe banues në Michigan, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, mbajtës i mbajtës i Pasaportës Amerikane me nr. 529552386, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar

themeloj një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sipas legjislacionit shqiptar në fuqi dhe në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë Statut.

**KREU I**  
**EMËRTIMI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA**

**Neni 1**  
**Emërtimi**

1.1 Shoqëria është krijuar në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar. Emërtimi i shoqërisë është GRAMOZI GREEN ENERGY shpk. Shoqëria do të fitojë personalitet juridik pas regjistrimit të saj në Regjistrin Kombëtar të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit.

1.2 Shoqëria ushtron aktivitetin e saj në përputhje me ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 "*Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare*" (i ndryshuar), legjislacionin shqiptar në fuqi dhe këtë Statut.

**Neni 2**  
**Objekti**

2.1 Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm: Studimi dhe projektimi, furnizimi, transporti, dorëzimi, ndërtimi, instalimi, riparimi dhe mirëmbajtja e impianteve të energjisë së rinovueshme (diellore, eolike, hidroelektrike, biomases elj.) dhe të njësive për ruajtjen e energjisë si dhe infrastrukturës së lidhur me to. Duke përfshirë por pa u kufizuar në linjat elektrike të tensionit të lartë dhe të mesëm, nënstacione elektrike dhe njësi të tjera të lidhjeve elektrike, rrugëve të aksesit etj., si dhe çdo aktivitet aksesor i lidhur me sa me sipër, si punime gërmimi, punime për prishjen dhe punime të tjera të tokës si dhe blerje, shitje, shkëmbim, import-eksport të pajisjeve, riparim dhe mirëmbajtje te materialeve dhe pajisjeve dhe te gjithë aktivitetet e lidhura me keto ceshtje, gjithashtu dhe ne fushen e aktiviteve te tregtimit. Përveç sa me sipër, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet që lidhet direkt ose indirekt, që është rezultat ose lidhet me objektin e mesipër. Për arritjen e qëllimit të mesipër, Shoqëria mund të kryejë çdo transaksion lidhur me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, dhe çdo aktivitet tjetër tregtar, financiar, qiraje ose htpoteke, që mund të konsiderohet i vlefshëm ose i nevojshëm në mënyrë që të ushtrohet objekti i Shoqërisë.



2.2 Me qëllim realizimin e objektit të aktivitetit të saj, Shoqëria mund të kryejë çdo veprimtari tjetër të nevojshme e të dobishme, të lejuar nga ligji.

### **Neni 3 Kohëzgjatja**

3.1 Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj për një kohëzgjatje të pacaktuar duke filluar nga momenti i regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar, sipas përcaktimeve të ligjit. Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një kohë të pacaktuar.

3.2 Prishja dhe likuidimi i Shoqërisë do të përcaktohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve në përputhje me dispozitat e këtij Statuti dhe legjislacionin në fuqi.

### **Neni 4 Selia**

4.1 Selia e Shoqërisë ndodhet ne adresën: Rruga e Durrësit, Pasuria Nr. 6/552-6, ZK 8310, Tiranë, Shqipëri.

4.2 Shoqëria, përmes vendimit të Asamblesë së Ortakëve, mund të krijojë degë, zyra, filiale dhe të zhvillojë aktivitet në vende të tjera, brenda ose jashtë territorit të Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin përkatës të zbatueshëm.

4.3 Adresa e faqes së internetit të Shoqërisë është [www.gramozigreenenergy.com](http://www.gramozigreenenergy.com).

4.4 Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon: [info@gramozigreenenergy.com](mailto:info@gramozigreenenergy.com).

## **KREU II KAPITALI**

### **Neni 5 Kapitali themeltar**

5.1 Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100,000 Lekë, e ndarë në 1 (një) pjesë/kuota, me vlerë nominale 100,000 (njëqind mijë) Lekë.

5.2 Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1.Ortaku themelues Adriatik Sheko:

Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 100,000 Lek që përben 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

5.3 Kontributi i Ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)



5.4 Përgjegjësia e Ortakëve kufizohet deri në vlerën e kontributit të tyre në kapitalin e Shoqërisë.

#### **Neni 6:**

##### **Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

6.1 Kapitali i Shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

6.2 Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një Ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

6.3 Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e Ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

6.4 Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek Ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

#### **Neni 7**

##### **Transferimi i kuotave**

7.1 Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

7.2 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet Ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

7.3 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

### **KREU III**

#### **ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE**

##### **Neni 8**


##### **Organi Vendimmarrës**

8.1 Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i Shoqërisë.

8.2 Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i Shoqërisë që miraton cdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara ne ligj.

8.3 Asambleja e përgjithshme e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;



- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

8.4 Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një Ortak tjetër apo nga një person i tretë.

8.5 Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i Ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

8.6 Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

## **Neni 9**

### **Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme**

9.1 Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t’u dërgohet të gjithë Ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.


9.2 Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë Ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

## **Neni 10**

### **Kuorumi**

10.1 Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë Ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

10.2 Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit “ Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare “, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse Ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.



10.3 Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

### **Neni 11** **Marrja e vendimeve**

11.1 Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit, të Ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

11.2 Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të Ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

11.3 Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e Shoqërisë.

### **Neni 12** **Përfshirja nga drejta e votës**

12.1 Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

12.2 Kur Ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, ky i fundit vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe Ortaku, të cilin përfaqëson.

### **Neni 13** **Administrimi**

13.1 Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

13.2 Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.



13.3 Personat e mëposhtëm caktohen si Administratorë të parë të shoqërisë deri në emërimin e tyre nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme.

Të dhënat e identifikimit:

dhe specimenët e nënshkrimit:

- Adriatik Nazmi Sheko,

Banues në 100 Chestnut Rdg Walled Lake, Michigan, SHBA.



#### **Neni 14**

#### **Kompetencat e Administratorëve**

14.1 Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

14.2. Administratorët janë të detyruar të thërrasin Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një Ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

14.3 Nëse Asambleja e Përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

14.4 Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme.

14.5 Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

#### **Neni 15**

#### **Përgjegjësitë e Administratorit**

15.1 Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

15.2 Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga Asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe Ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose të përbashkët (sipas rastit) pasojat përkatëse.

15.2 Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtarët dhe Shoqërite Tregtare", administratori detyrohet:

- a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
- d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

15.3. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.


15.4. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

15.5. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë Shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen Ortakëve kontributet;
- b) u paguan Ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
- ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

15.6 Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, Ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit

15.7 Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.



**KREU IV**  
**VITI FINANCIAR-EKSPERTËT**

**Neni 16**

**Viti Financiar**

16.1 Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

**Neni 17**

**Ekspertët**

17.1 Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të Shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e Ortakëve.

17.2 Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë Ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që zotëron.

**KREU V**  
**PRISHJA - RIORGANIZIMI I SHOQËRISË**

**Neni 18**

**Prishja dhe likuidimi**

18.1 Shpërndarja ose prishja e Shoqërisë mund të bëhet në cdo kohë:

- a) me vendim të Asamblese së Ortakëve;
- b) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- d) me vendim të gjykatës;

18.2 Në këtë rast Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të Shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shënuar në cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtesë "Shoqëri në likuidim e sipër".

18.3 Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë pagueuse, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

18.4 Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

**Neni 19**

**Riorganizimi i shoqërisë bashkimi-ndarja**





19.1 Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vednimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

#### **Neni 20**

##### **Baza Ligjore**

20.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislatcionit shqiptar.

20.2 Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

#### **Neni 21**

##### **Mosmarrëveshjet**

21.1 Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

#### ***ORTAKET***

#### ***E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR***

#### ***GRAMOZI GREEN ENERGY***



*Adriatik Sheko*

*(nënshkrimi)*